



PLANI VJETOR ADMINISTRATIV

I MENAXHIMIT TË RISKUT

TË PAJTUESHMËRISË

2016

Pasqyra

I. BAZAT MBI TË CILAT MBËSHKETET KRIJIMI DHE ZBATIMI I PLANIT VJETOR LIDHUR ME MENAXHIMIN E RISKUT TË PAJTUESHMËRISË.....	2
II. FILOZOFIA E ADMINISTRATËS PËR PAJTUESHMËRINË.....	3
III. QASJA NË ZHVILLIMIN E PLANIT TONË, NË MENAXHIMIN E RISKUT TË PAJTUESHMËRISË.....	5
IV. NJOHJA ME MJEDISIN TONË – NJË VLERËSIM AKTUAL.....	8
V. EVIDENTIMI I SEKTORËVE TË EKONOMISË QË KANË NIVEL TË LARTË PAPAJTUESHMËRIE	12
VI. FUSHATA TË VEÇANTA TË PAJTUESHMËRISË NË 2016.....	14
VII. MONITORIMI DHE MATJA E PAJTUESHMËRISË.....	16
MATJA OBJEKTIVE E SUKSESIT.....	17

PLANI VJETOR ADMINISTRATIV I MENAXHIMIT TË RISKUT TË PAJTUESHMËRISË 2016

Administrata tatimore është e angazhuar të implementojë një qasje të re, koherent të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë.

Për të patur një kornizë të menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë dhe një metodologji pune, është e nevojshme t'i adaptojmë ato si pjesë e mënyrës së bërit të punës, të na japë mundësinë të jemi të qartë se si duhet të përqendrojmë energjitë tona, duke adresuar çështjet e duhura për industrinë, sektorët dhe tatimpaguesit e duhur.

Për ta bërë këtë, qasja e menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë ka nevojë të jetë pjesë e kornizës së planit të punës, reflektuar në proceset tona të drejtimit dhe në marrëveshjet tona për vlerësimin e rezultateve dhe performancës.

I. BAZAT MBI TË CILAT MBËSHTETET KRIJIMI DHE ZBATIMI I PLANIT VJETOR LIDHUR ME MENAXHIMIN E RISKUT TË PAJTUESHMËRISË

Plani vjetor i Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë hartohet për zbatim duke u mbështetur në themel të:

- Strategjisë së organizatës për zhvillimin e Administratës Tatimore
- Strategjisë për përmbushjen tatimore
- Planit operacional të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut
- Strategjisë dhe planit kundër informalitetit
- Përshtatjes me Praktikën më të mira Ndërkombëtare sa i përket Trajtimit të Pajtueshmërisë

II. FILOZOFIA E ADMINISTRATËS PËR PAJTUESHMËRINË

Administrata tatimore e konsideron Menaxhimin e Riskut të Pajtueshmërisë si pjesë përbërëse dhe integrale të zhvillimit të kulturës fiskale në tërësi; kjo veçanërisht duke marrë në konsideratë një mjedis ekonomik, dinamik i cili kërkon paralelisht me zhvillimin ekonomik edhe përmbushjen e pritshmërive prej tatimpaguesve karshi legjislacionit fiskal, gjithashtu në kuadër të mbështetjes me anë të procesve integruese, të një Shqipërie Evropiane.

Janë pikërisht:

Vizioni: që synon arritjen e një stadi ku të jemi administratë tatimore evropiane, në mbështetje të qytetarëve për rritjen e mirëqenies së tyre, duke luajtur plotësisht rolin tonë në proceset integruese evropiane.

Misioni: i cili synon mbledhjen e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Vlerat: me fokus të qenit partner profesionistë me tatimpaguesin, duke i shërbyer me integritet, profesionalizëm, bashkëpunim, transparencë dhe etikë.

të cilat shërbejnë si bazë dhe inspirim për krijimin dhe zbatimin e një plani vjetor efektiv sa i përket menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë, e cila po ashtu duhet të jetë në kohezion edhe me strategjinë organizative dhe atë të përmbushjes tatimore.

Ne po punojmë për të kuptuar se si faktorë të ndryshëm influencojnë në hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë, në mënyrë të veçantë si: eksperiencat, perceptimet, qëndrimet, sjelljet - kërkojmë mundësi për t'i shfrytëzuar si një avantazh për ne.

E gjithë kjo në mënyrë të tillë që ato të ndikojnë pozitivisht në pajtueshmërinë e cila do na japë mundësinë të përshtasim sjelljet tona në terma afatgjatë, me qëllim arritjen e zhvillimit të një motivimi të brendshëm, ndërkohë që ne menaxhojmë sjelljet në periudha afatshkurtra.

Në praktikë, ky proces do të implementohet nëpërmjet programeve të pajtueshmërisë që shfrytëzojnë mjetet e ndryshme që kemi në dispozicion, dhe po ashtu, duke marrë në konsideratë edhe sjelljet e gjithësecilit, të cilat me kalimin e kohës ndryshojnë ambientin.

Për të paraqitur filozofinë tonë të pajtueshmërisë kemi adaptuar parimet e mëposhtme:

1. Menaxhojmë rreziqet e pajtueshmërisë gjatë ciklit të jetës së tatimpaguesit;
2. Për ta mundësuar këtë, ne kemi nevojë ta bëjmë riskun më transparent, si dhe ta kuptojmë më mirë atë;
3. Nuk përqëndrohemi te tatimpagues të veçantë, por fokusohemi te një panoramë më e gjërë;
4. Grupe të ndryshme kanë nevoja dhe sjellje të ndryshme – dhe janë të ekspozuar ndaj risqeve të ndryshme – kështu edhe ne e fragmentojmë bazën e tatimpaguesve;
5. Ne shpërndajmë burimet bazuar në riskun – targetojmë çështjet dhe tatimpaguesit e duhur;
6. Merremi me arsyet kryesore të papajtueshmërisë – jo thjesht me simptomat;
7. Përdorim varietete mjetesh për t’iu përgjigjur dhe zbutur riskun;
8. Vendimmarrjet dhe strategjitë i mbështesim mbi të dhënat dhe analizat;
9. Ne kemi një strukturë të ngritur që mbështet planin e punës për menaxhimin e riskut - në nivel të brendshëm, si dhe përmes partneritetit dhe bashkëpunimit me organet e jashtme.

III. QASJA NË ZHVILLIMIN E PLANIT TONË, NË MENAXHIMIN E RISKUT TË PAJTUESHMËRISË

Si është trajtuar menaxhim i risqeve ndaj përmbushjes së detyrimeve të tatimpaguesve?

Përvoja ndërkombëtare tregon se qasjet strategjike dhe planet mund dhe duhet të fokusohen së tepërmi në rritje të të ardhurave të qëndrueshme tatimore përmes rritjes së përmbushjes së detyrimeve të tatimpaguesit.

- Kjo ka çuar në hartimin e modelit të informatizuar të menaxhimit të riskut me asistencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- Guri i themelit është mbështetja të strategjia organizative, dhe në mënyrë të veçantë ajo e përmbushjes, mbi bazën e të cilave do hartohet edhe plani i Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë.

Në tërësinë e tij Menaxhimi i Riskut përpiqet t'i japë vlerë administrimit të fiskut duke u bazuar karahas të tjerave, paralelisht edhe në mundësinë e ndikimit në zbutjen e papajtueshmërisë nëpërmjet ndikimit në:

• Legjislacion	→ <i>Ndryshime dhe përmirësime në ligjet ekzistuese duke u kordinuar edhe me tatimpaguesit dhe grupet e interesit</i>
• Teknologjia	→ <i>Shërbimet elektronikë të përmirësuar</i> → <i>On-line për shërbimet e ofruara</i>
• Edukimi	→ <i>Ofrimi i shërbimeve të edukimit fiskal dhe ligjor për grupet me risk të lartë</i> → <i>Kryerja e seminareve trajnuese</i> → <i>Publikimi i materialeve dhe ofrimi i tyre për tatimpaguesit, Publikim i broshurave</i>
• Inkurajimi i deklaramit dhe përmbushjes vullnetare	→ <i>Ofrimi i linjave on-line</i> → <i>Ofrimi i zyrave të tipit "Help desk", etj.</i>
• Angazhim dhe partneritet me industrinë	→ <i>Konsiderimi i industrive si partnere duke ofruar shkëmbim konsulence për trajtimin e fenomeneve</i>
• Kujtesa për shlyerjen e detyrimeve / mbledhja e borxhit	→ <i>Kujtesë tatimpaguesit për detyrimet gjendje për likuidim në kohë</i> → <i>Kujtesë me telefon, e-mail, postë, kontakt, etj.</i>
• Kontrolli	→ <i>Kontrolli i tvsh-së në rastin e kërkesave për rimbursim</i> → <i>Grupe këshilluese auditit sipas projekteve për sektorë ekonomikë të veçantë</i> → <i>Kontrolle të veçanta, etj.</i>
• Angazhimi me median	→ <i>Komunikim korrekt me median</i> → <i>Publikimi i rezultateve</i> → <i>Publikimi i rasteve me shkelje flagrante</i>

- Më konkretisht, plani vjetor i menaxhimit të pajtueshmërisë konsiston në dy kategori të gjëra:
 - A. Mbrojtja e principeve të riskut të pajtueshmërisë, si dhe qasja me aktivitetet tona të punës së përditshme;
 - B. Zhvillimi i fushatave për çështje dhe industri specifike të cilat përqëndrohen në pajtueshmërinë e sjelljeve, në këto industri specifike.

Të dy kategoritë aplikojnë metodologji të ngjashme:

i. Fillojmë me një vlerësim të mjedisit

Çfarë po vëmë re?
 Çfarë po na tregojnë të dhënat?
 Çfarë ka ndryshuar?

ii. Punojmë për të kuptuar se cilat janë çështjet me rëndësi dhe faktorët që formëzojnë atë që ne vështojmë

Çfarë mendojnë stafi dhe bashkëpunëtorët tanë se cilat janë çështjet me rëndësi për t'u trajtuar?
 Çfarë na sugjerojnë partnerët tanë?
 Cilat trende makroekonomike janë në lojë?

iii. Cili është qëllimi i ynë strategjik në lidhje me këtë?

Cili është rezultati që duam të arrijmë?

iv. Prandaj, cilat janë hapat praktikë që na nevojiten të bëjmë?


Si paraqitet kuadri ekzistues i legjislacionit tatimor për të identifikuar pengesat apo avantazhet kundrejt objektivit të synuar?
 Cilat janë propozimet që mund të bëjmë?
 Si do të strukturohemi për të qenë fleksibël, operativë dhe efektivë?
 Si do të ndërtohen, zbatohen, mbikqyren dhe vlerësohen planet?

- ▣ Kjo përbën esencën e planit tonë të aktiviteteve për të gjitha njësitë e biznesit përmes Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë.

Duke u mbështetur edhe në synimin e përmbushjes tatimore do të:

→ Ngremë struktura dhe sisteme të fuqishme për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informatave për shmangie dhe/ose mashtrim tatimor, në mënyrë të veçantë për risqet e lidhura me përmbushjen e detyrimeve tatimore.

E gjitha kjo kërkon hartimin dhe zbatimin e planeve në linjë me strategjinë e Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë, me synim zbutjen, e deri në eliminimin e grupeve madhore të risqeve të identifikuar, kryesisht në bazë segmentesh të tatimpaguesve. Ilustrimi në vijim paraqet skemën klasike të trajtimit të riskut në kontekstin fiskal:



IV. NJOHJA ME MJEDISIN TONË – NJË VLERËSIM AKTUAL

Një prej pikave kyçe në prezantimin e qasjes së menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë, sa i përket administratës tatimore, nënvizon faktin se ne duhet të fillojmë të kuptojmë ambientin tonë, me çdo sektor që kryen një aktivitet korrent.

Për qëllime të planit vjetor të 2016 synojmë t'u japim prioritet disa iniciativave kyqe.

Për sa i përket këtij plani fokusoheми më qartë në vlerësimin korrent në nivel baze tatimore dhe aty ku është e nevojshme, në mënyrë specifike edhe në nivel sektori, për të bërë të mundur njohjen me hapat e tjerë të rrugës tonë në pajtueshmërinë e menaxhimit të riskut.

Kjo është e realizueshme nëpërmjet koordinimit dhe bashkëveprimit të punëve dhe objektivave në nivel drejtues, taktik dhe operacional, duke qenë në linjë me synimet e organizatës, si dhe marrjen në konsideratë në çdo moment të të dhënave/informacioneve që orientojnë në vendimmarje ku përfitimet afatgjata në rang kombëtar do të jenë më të mëdha se kostot afatshkurtra.

Pra theksi të “Shtimi i vlerës dhe jo thjesht të fitimit”.

Koordinimi i punës dhe bashkëveprimi në nivele strategjike drejtimi, taktike dhe ato operacionale do të përbëjë avantazh sa i përket trajtimit të riskut.

- ✚ **Niveli strategjik** – përgjegjës për menaxhimin e bazës së të dhënave, monitorim të ndryshimeve të ambientit të jashtëm, sa u përket ndryshimeve të cilat potencialisht mund të kenë një impakt të rëndësishëm për administratën dhe proceset e Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë;

kjo duke përdorur indikatorë makroekonomikë, trende demografike, analiza të sjelljeve, analiza të shmangies tatimore, profilizime të popullatës së tatimpaguesve, dhe modele risku për të zhvilluar modelet e pajtueshmërisë,


si dhe për të siguruar modele kërkimi-zhvillimi që lejojnë marrjen e vendimeve në funksion të strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë.

- ✚ **Niveli taktik** – përgjegjës për identifikimin, analizën e zhvillimin e pyetjeve sa i takon pajtueshmërisë, veçanërisht në lidhje me regjistrimin, plotësimin, raportimin dhe pagesat;

kjo duke zhvilluar analizat sipas sektorëve dhe asistuar në riorientimin dhe dhënien prioritet risqeve kryesore të identifikuara.

- ✚ **Niveli operacional** – përgjegjës për kryerjen e punës në harmoni dhe kohezion me strategjinë e nivelit drejtues, me qëllim analizën e risqeve specifike, kupitimin e tyre, si dhe dhënien drejtim sa i takon alternativeve për zgjidhje.

Ilustrim i koordinimit dhe bashkëveprimit në funksion të menaxhimit të riskut:



Dimensionet e analizës: N. Strategjik * Taktik * Operacional

a) Trendi i Menaxhimit të Riskut të Pajftueshmërisë

1	REGJISTRIMI
Masat	<i>Do të rritet vigjilenca për të identifikuar dhe regjistruar palët që ushtrojnë aktivitete ekonomike në mënyrë informale</i> <i>Do të evidentohen regjistrimet fiktive, thjesht për të përfituar nga rimbursimet e tatimit mbi vlerën e shtuar apo tatimit mbi fitimin</i>
2	MBAJTJA E LIBRAVE/LLOGARIVE
Masat	<i>Do të kryhen vizita këshilluese te tatimpaguesit</i> <i>Do të hartohen fletëpalosje sipas industrive specifike</i>
3	PLOTËSIMI NË KOHË
Masat	<i>Do të asistojmë tatimpaguesit sipas segmente të veçata</i>
4	EDUKIMI
Masat	<i>Do të kërkohen të dhëna shitesë për t'u përpunuar në funksion të informacioneve të vlefshme për vendimmarrje, për programet dhe grupet e trajnimit</i> <i>Programet e trajnimit duhen përqëndruar dukshëm te sektorët me nivel të lartë papajtueshmërie me kuadrin fiskal</i>

5	AUDITI/KONTROLI
Masat	<i>Kemi synim zhvillimin më tej të një sistemi të aftë të prodhojë raporte që evidentojnë më lehtë shkelësit, pa patur nevojë t'i analizosh të gjithë me radhë</i>
	<i>Do zhvillojmë model kontrolli të përqëndruar te tatimpaguesit me risk të lartë</i>
	<i>Rrit cilësinë e kontrolleve përmes kualifikimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të inspektorëve, diskuto rastet, çështjet e ndryshme</i>
	<i>Rishiko mënyrën e aplikimit të penaliteteve me qëllim influencimin në sjellje</i>
	<i>Kontrolle për kërkesat për rimbursim me bazë risku</i>
6	PAGESA E DETYRIMEVE / BORXHEVE
Masat	<i>Do të rishikikohet libri i detyrimeve dhe borxheve</i>
	<i>Do kërkohet se cilat janë shkaqet e mospagimit të detyrimeve apo borxheve</i>
	<i>Do komunikohet me tatimpaguesin</i>
	<i>Do të merren në konsideratë mundësitë e kompensimit automatik të detyrimeve dhe penaliteteve në të drejtat e mbartura në sistem që ka tatimpaguesi</i>
	<i>Do të gjinden zgjidhje ligjore me mirëkuptim, etj.</i>
7	INVESTIGIMET PËR EVAZION DHE KALIMI PËR NDJEKJE PENALE
Masat	<i>Do të implemetohet një proces "feedbacku" për t'u siguruar për ecurinë e çështjeve që kanë kaluar për hetim</i>
	<i>Do i jepet përparësi rasteve që ushtrojnë aktivitet pa qenë të regjistruar</i>
	<i>Do fokusohemi te evezioni fiskal, psh mosdeklarimi qëllimisht i shitjeve</i>

b) Një vlerësim i maturimit të pajtueshmërisë

Ne kemi bërë progres në vlerësimin e maturimit të pajtueshmërisë së menaxhimit të riskut. Ka disa zona ku përmirësimet janë të domosdoshme, të nevojshme dhe kërkohen me qëllim optimizimin e riskut të pajtueshmërisë, si dhe të influencojnë sjelljet e tatimpaguesit në mënyrë më të drejtpërdrejtë.

Plani vjetor i riskut, ndërtuar edhe në funksion të strategjisë, koniston në evidentimin vazhdimisht të problematikave dhe zgjidhjen e tyre duke vendosur bazat e duhura.

Përbërësit e MRP	Boshllëqet aktuale	Prandaj në 2016 ne do të:
Identifikimi i rrezikut	Ne nuk mund ta barazvlerësojmë pajtueshmërinë, thjesht, me "pagimin në kohë të detyrimeve"	<ul style="list-style-type: none"> Të mbështesim idenë që pajtueshmëria lidhet me regjistrimin, mbajtjen e të dhënave në mënyrë të rregullt, plotësimi i saktë i deklaratave, plotësimi dhe pagesë në kohë, sipas llojit të tatimit.
	Pasurimi i bazës së depozitimit të të dhënave	→ Ngritja e një baze të depozitimit të të dhënave (Data warehouse)
	Kriteret e riskut të përqëndruara në informacione të brendshme	→ Zhvillim i rregullave, duke marrë në konsideratë edhe të dhëna nga doganat dhe palë të treta

Analiza e riskut	Përqëndrimi i madh në kuptimin e industrive ose praktikave të biznesit me risk të lartë	→ Rishikim në nivel makro i riskut të pajtueshmërisë dhe mundësive – kuptimin e industrive ose praktikave të biznesit me risk
Prioritetet e riskut	Industri dhe sektorëve të caktuar t'u jepet prioritet për kryerjen e fushatave (të menaxhimit të riskut)	→ Rishikim dhe krahasim i i riskut / krahasim për të parë dhe caktuar idustritë dhe bizneset me më shumë risk → Implementim i organizimit me bazë të gjërë për fushatat e pajtueshmërisë
	Dhënia prioritet e menaxhimit të riskut të pajtueshmërisë, thjesht si kontroll	→ Futja e vlerësimit korrent të pajtueshmërisë së menaxhimit të riskut, për çdo sektor dhe njësi biznesi, si pjesë përbërëse e planit vjetor të punës.
	Dhënia prioritet të lartë të borxheve/detyrimeve të reja	→ Ndërtim dhe dhënie prioritet e kornizës së menaxhimit të borxhit
Trajtim i riskut të pajtueshmërisë	E parë në kontekstin e kontrollit: Vendosja e një qasje të duhur për parandalimin e shkeljeve të përsëritura	→ Forcimi i idesë se MRP është relevante ndaj çdo sektori dhe njësie biznesi – ajo është më shumë se “qasje auditit” → MRP ka të bëjë me punën e gjithësecilit
	Rritja e rolit të konsulentëve fiskalë	→ Zhvillim i strategjisë për konsulentët fiskalë → Ndërtim i grupit të punës me konsulentët fiskal → Rishikim në nivel makro i sjelljes së konsulentëve fiskalë
	Rritja e kapaciteteve të kontrollit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Forcim i ndjeshëm i strukturave audituese ▪ Zhvillim i programeve për kontrollin (industri me risqe specifike, pyetje të ngritura, dokumenta për t'u kontrolluar)
Monitorim dhe matje	Monitorim të trendit të riskut të pajtueshmërisë	→ Menaxhim dhe raportim i të dhënave dhe analizës së tyre
	Matja e rezultateve	→ Përshtat një seti vlerësimesh të treguesve lidhur me performancën
Vlerësim dhe përshtatje	Vlerësimi nëse aktivitetet tona, aktualisht ndryshojnë sjelljen për pajtueshmërinë	→ Rishikim vjetor i trendit të pajtueshmërisë për çdo sektor → Rishikim në nivel drejtues

V. EVIDENTIMI I SEKTORËVE TË EKONOMISË QË KANË NIVEL TË LARTË PAPAJTUESHMËRIE

Qëllimi - Zbatimi i një qasje moderne për përmbushjen tatimore:

Të kemi një qasje moderne për menaxhimin e riskut të përmbushjes tatimore që të nxisë përmbushjen vullnetare dhe të përqendrohet tek identifikimi dhe zbutja e risqeve madhore që i kanosen sistemit tatimor.

Objektiv Menaxhimi i Riskut të përmbushjes tatimore:

Do të ngremë struktura dhe sisteme për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave dhe informatave për tendencat dhe risqet e lidhura me përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe për hartimin dhe zbatimin e strategjive me synim zbutjen grupeve madhore të risqeve të identifikuar, kryesisht në bazë segmentesh të tatimpaguesve.

Më konkretisht:

Analiza e përgjithshme mbi shpërndarjen e riskut në rajonet tatimore dhe në sektorët ekonomikë prioritarë hartohen duke u mbështetur në rezultatet e gjeneruara nga kriteret e riskut, për numrin e tyre të thyer, si dhe tatimin e rrezikuar të llogaritur nga të gjitha kriteret, për secilin tatimpagues.

Më konkretisht, në tabelën në vijim jepen sipas riskut që parqasesin, sa u takon rregullave të thyera, aktivitetet ekonomike që kanë nivelin e papajtueshmërisë më të ulët, me qëllim dhënien prioritet për t'i trajtuar sektorët që paraqesin një nivel të lartë shmangie.


Nr.	PËRSHKRIMI I SEKTORIT	Tatimet, taksat e paguara në %	Tatimi në rrezik në %	Rregullat/ kriteret e thyer në % ndaj totalit të tatimpaguesve me risk
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>e</i>
1	TREGTI MEPAKICË	4.25	3.63	18.26
2	TREGTI ME SHUMICË	19.53	20.99	16.69
3	SHËRBIME PROFESIONALE TË BIZNESIT	4.64	2.74	10.42
4	NDËRTIME PUBLIKE	8.85	7.11	9.22
5	HOTELE DHE RESTORANTE	1.27	1.08	7.25
*13	ENERGJI ELEKTRIKE, GAZ, UJË	10.07	12.99	1.78
*26	POSTA DHE TELEKOMUNIKACIONI	4.35	20.09	0.76
6	Shëndet dhe ana sociale	1.26	0.91	4.58
7	Mjete motorike, me shumicë dhe pakicë, pjesë për motorë	4.82	1.93	2.82
8	Metale, makineri, pajisje, të tjera	1.85	1.06	2.74
9	Transport rrugor	1.17	1.49	2.64
10	Krijon një grup logjik, ushqimore, pije duhan	1.19	1.2	2.35

11	Administrim publik	5.26	1.01	2.19
12	Petro-kimike, plastikë, qelq, qeramikë, tulla	2.61	2.05	2.05
14	Miniera dhe gurore	4.74	3.22	1.44
15	Tekstile, rroba, lëkurë	1.74	1.56	1.36
16	Organizata vullnetare	0.72	0.27	1.34
17	Financë, sigurime, letra me vlerë, shërbim brokeri	4.76	6.14	1.28
18	Trajtim i mallrave kargo, magazinim dhe shërbime transporti	3.7	3.06	1.25
19	Pastrim kimik, parukeri, funerale	0.39	0.24	1.12
20	Qiradhënie e pasurive të patundshme	3.19	1.29	1.05
21	IT dhe informaike	1.02	0.49	1.04
22	Rekracione, sporte	1.24	1.19	0.92
23	Dru, letër	0.44	0.21	0.88
24	Bujqësi, pylltari, peshkim	0.32	0.42	0.8
25	Printime, botime, media	0.47	0.25	0.79
27	Kanalizime, instalime elektrike, instalime të tjera	0.27	0.63	0.7
28	Punimet tjera të ndërtimit	0.18	0.21	0.54
29	Edukim, arsimim	0.88	0.15	0.54
30	Peshkim	0.1	0.25	0.31
31	Prishje dhe gjermim	0.07	0.04	0.18
32	Pastrim dhe kanalizim	0.14	0.03	0.17
33	Baste, aktivitete të kumarit	3.42	0.13	0.17
34	Qiradhënie e automjeteve dhe makinerive	0.07	0.14	0.15
35	Transport ajror	0.53	0.65	0.11
36	Riciklim i metaleve dhe i skrapit	0.22	0.24	0.1
37	Transport ujor	0.21	0.87	0.08
38	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	0.14	0.06	0.06
39	Aktivitete/shërbime shtëpiake	0	0.01	0.04
40	Kërkim & zhvillim, shkencë	0.03	0	0.02
41	Qiradhënie e makinerive të ndërtimit	0.01	0	0.01

Nga sa më lart, evidentohet se sektorët me më shumë rregulla të thyera sa i takon pajtueshmërisë janë tregtia me pakicë dhe ajo me shumicë e mallrave, sektorë të cilët do të kenë prioritet në trajtim përgjatë vitit 2016.

VI. FUSHATA TË VEÇANTA TË PAJTUESHMËRISË NË 2016

- ⊙ **Fushata:** Konsolidimi dhe zgjerimi i bazës së tatimpaguesve të regjistruar me TVSH duke shmangur abuzimet me taksën 0



Një vështrim në mënyrë sintetike paraqitet në skemën sa më lart, lidhur me mundësinë e operimit bazuar në listat e përzgjedhura nga Risku:

Për çdo kategori të tatimpaguesve janë përgatitur njoftime specifike sensibiluese dhe informuese, në vartësi të problematikës së tatimpaguesit.

Meqenëse ky vit është po ashtu vijim i përmirësimit të luftës kundër informalitetit, edhe plani i veprimeve, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe partnerët është në funksion të kësaj sipërmarrje me objektiv kryesor:

RRITJE E BAZËS SË TATIMPAGUESVE TË RREGJISTRUAR NË TVSH

- ✓ Hartimi në kordinim dhe me kontributin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të DPT-së: Plan i Veprimeve Kundër Informalitetit;
- ✓ Zhvillim në MF, nën drejtimin e Ministrit, takim me drejtuesit e administratës tatimore qendrore dhe rajonale për zbërthimin e kuptimin e planit të veprimit;
- ✓ Krijim në DPT i Grupit të Monitorimit të punës së DRT-ve;
- ✓ Përpunim dhe seleksionim i 10 listave me tatimpagues të identifikuar me risk të lartë për fenomene specifike;
- ✓ Dërgimi DRT-ve, plani i veprimeve kundër informalitetit, si dhe 10 listat e tatimpaguesve të identifikuar me risk më të lartë:

*** Filozofia jonë për matjen e pajtueshmërisë**

Në respekt të pajtueshmërisë me të dyja: efektivitetin (“të bësh gjënë e duhur”), dhe efikasitetin (“të bësh gjërat siç duhet”).

Me qëllim vlerësimin se si po punojmë në frontin e pajtueshmërisë, ne duhet të rishikojmë performancën e pajtueshmërisë, po aq sa perceptimet dhe qëndrimet, si indikatorë të sjelljeve të ardhshme.

Nëse strategjitë tona të pajtueshmërisë janë efektive në ndryshimin e sjelljeve, atëherë, me kalimin e kohës ne duhet të shohim se sa të prekshme dhe të qëndrueshme janë këto përmirësime në sjelljen karshi pajtueshmërisë.

Matja e pajtueshmërisë duhet të dominojë kryesisht për monitorimin e trendeve – ndërsa numrat në vlerë absolute janë të rëndësishme, ato marrin një rëndësi të veçantë kur shikohen në kontekstine trendeve më të gjera.

Së fundmi, matja e pajtueshmërisë duhet të na japë ne mundësinë për të vlerësuar gjendjen aktuale të qëndrimeve dhe sjelljeve në raport me pajtueshmërinë, të vlerësojmë atë se si duam ne që këto qëndrime dhe sjellje të jenë, dhe më pas, të vëmë një seri lëvizjesh sa u takon aktiviteteve të cilat ndryshojnë, përmirësojnë ose mbajnë një nivel të caktuar të pajtueshmërisë në sjellje.

Të dhënat në lidhje me pajtueshmërinë duhet të jenë në dispozicion, në mënyrë analitike dhe sintetike, në një formë që mundëson lehtësisht rishikimet për ndryshime kohe pas kohe.

*** Korniza jonë e matjes së pajtueshmërisë**

Balancimi i kornizës tonë për matjen e pajtueshmërisë do të jetë e bazuar në:

- Vlerësimi i rezultateve:
 - Matja sasiore “produkteve” të lidhura, tipike që përfshijnë “volume të mëdha”, vlera të mëdha kohe, norma të mëdha mbulimi. Kjo do të vlejë për shumicën e matjeve që ne gjurmojmë.
 - Matja cilësore e “produkteve” të lidhura, tipike që përfshijnë rishikime të sigurisë, bazuar në ankesat dhe % të vlerësimeve të kryera.
 - Impakti / vlerësimi i masave të marra, e cila duket menjëherë në terma afatshkurtër se si ka qenë ndikimi në qëndrime dhe sjellje (të tatimpaguesve)
- Vlerësimi i feedback-ut:
 - Ndryshimi i sjelljeve, e cila matet përmes vëzhgimeve, sondazheve, publikimeve në media, ndikimet në grupet e interesit.
 - Ndryshimet në sjellje:

MATJA OBJEKTIVE E SUKSESIT

ÇFARË BËMË NE?	ÇFARË KEMI ARRITUR?
	CILI ËSHTË NDRYSHIMI QË KEMI KRYER?

1. Një regjistër i pastër i tatimpaguesve, sa janë regjistruar, sa aktualisht janë aktivë?
 - *Të dimë realisht së cila është hapësira që kemi nën monitorim*
2. Përmirësimi i mënyrës së mbajtjes së regjistrimeve dhe llogarive prej tatimpaguseve:
 - *Sa ka ndikuar procesi ynë i menaxhimit dhe monitorimit të pajtueshmërisë në nivelin profesional të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit nga ana e subjekteve.*
3. Përmirësimi i saktësisë së plotësimit të deklaratave dhe i kohës së deklarimit të tyre brenda a fatave të paracaktuara:
 - *Një arritje e tillë siguron pasqyrim në kohë reale dhe me më shumë vërtetësi të transaksioneve ekonomike dhe efekteve që kanë ato për fiskun.*
4. Përmirësimi i pagesës së detyrimeve brenda afatave të paracaktuara:
 - *Kjo sjell një ndikim pozitiv në raportimin e të ardhurave nga administrata dhe garanci në projektimin për të ardhmen, veçanërisht si ndihmë e dikastereve që merren me rishpërndarjen e këtyre të ardhurave.*
5. Përmirësimi i menaxhimit të rasteve të borxhit; të lehtësojnë mundësinë e pagesave nëpërmjet aplikimit të marëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura:
 - *Reflektimi në lehtësinë që u jepte bizneseve sa i takon shlyerjes së detyrimeve nëpërmjet kësteve, pa u rëndëuar në një pagese të vetme totale.*
6. Përmirësojnë aftësinë e të kuptuarit të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë, rezultatet, llojet dhe vlerat e zbulimeve:
 - *Një vlerësim sa i takon arrijeve të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë ka të bëjë edhe me nivelin dhe lojin e zbulimeve gjatë kontrolleve/auditeve të ushtruara.*

7. Të reduktojnë nr. e problemeve apo kohën e nevojshme për zgjidhjen e tyre:
- *Menaxhimi i Riskut të Pajtueshmërisë vlerësohet pozitivisht nëse tërësisë së problemeve të evidentuara arrihet t’u jepet drejtim dhe zgjidhje korrekte dhe në kohë reale, pa vonesa të tepërta burokratike.*
8. Redukto barrën e të kuptuarit dhe implementimit të pajtueshmërisë; synimi përfitimi më i madhe se kosto:
- *Një parametër i mirë i Menaxhimi i Riskut të Pajtueshmërisë evidentohet në faktin se sa administrata arrin të kuptojë se cilat janë nevojat e subjektit dhe krijimin e një kuadri fiskal që harmoizon nevojat e subjekteve me legjislacionin.*
9. Proçese jo thjesht statike, por dinamike dhe të zgjuara. Elastike në proçesin e vendimmarrjes, matjes dhe vlerësimit, si dhe sugjerimeve:
- *Menaxhimi i Riskut të Pajtueshmërisë vlerësohet se arrin sukses edhe në sajë të aftësisë së këtij planifikimin në nivel strategjik dhe operacional për t’iu përgjigjur në kohë reale dhe me kosto të moderuara edhe ndryshimeve ekonomike dhe sociale.*